

 Njoftim nga Shkolla Shqipe Naples

Të dashur prindër dhe anëtarë të komunitetit,

duam t'ju mbajmë të përditësuar për ndryshimet që po implementojmë këtë vit shkollor:

-  Uniforma të reja: Të gjithë nxënësit do të kenë bluza uniforme të bardha me logon e shkollës.
-  Siguria dhe transparenca: Të gjithë mësuesit dhe stafi i Shkollës Shqipe do t'i nënshtrohen kontrolleve të sfondit për sigurinë e nxënësve.
-  Materialet mësimore: Çdo nxënës do të marrë tekst, fletore pune dhe abetare.
-  Mosha minimale: Për shkak se kemi vënë re që nxënësit më të vegjël nuk ishin ende gati për kohëzgjatjen e programit tonë, mosha minimale për regjistrim tani është 6 vjeç; për grupin 1 kërkohet kopje e certifikatës së lindjes.
-  Hapësira të zgjeruara: Këtë vit kemi zgjeruar qiranë për 3 klasa dhe kafeterinë për të përballuar numrin e madh të nxënësve.
-  Siguria në marrjen e fëmijëve: Formulari i regjistrimit do të përfshijë një listë me persona të autorizuar për marrjen e fëmijës; ata duhet të tregojnë një ID me foto në momentin e marrjes.
-  Klasa e poezisë: Për grupet 2 & 3, klasa e poezisë është bërë zyrtarisht pjesë e kurrikulës.
-  Transparenca financiare: Qiraja për përdorimin e hapësirave nga Collier County School District vazhdon të jetë falas, por këtë vit po na ngarkohet një tarifë prej \$100/javë për shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit. Si gjithmonë, të gjitha regjistrat financiarë do të jenë të postuara në pikën e regjistrimit të shkollës dhe të disponueshme me kërkesë për të gjithë prindërit e Shkollës Shqipe.
-  Anëtarësimi i detyrueshëm: Për t'u regjistruar si nxënës i Shkollës Shqipe Naples, familja juaj duhet të ketë anëtarësim vjetor me Albanian American Organization of SW Florida prej \$100/vit.
-  Kërkojmë sponsorë: Për të mbështetur programet dhe aktivitetet tona, jemi duke kërkuar sponsorë. Ju lutemi na kontaktoni në shkollashqipe@aao-swfl.org nëse jeni të interesuar.
-  Kërkojmë vullnetarë: Jemi gjithmonë në kërkim të vullnetarëve për të ndihmuar në programet tona dhe aktivitetet e shkollës. Nëse jeni të interesuar, ju lutemi na kontaktoni në shkollashqipe@aao-swfl.org.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme!

Shkolla Shqipe Naples